



“Dirhemi” Në Kohën e Jusufit

Description

M S M Saifullah, `Abdullah David & Muhammad Ghoniem

1. Hyrje

Dhe e shitën atë (Jusufin) për një çmim të vogël, për disa dirhemë (masë argjendi) [*dar?hima ma'd?datin*] të numëruar, sepse në mesin e tyre pati asash që nuk lakmuan (për çmim më të lartë). [Kuran 12:20]

Në historinë e Jusufit (Jozefit) në Kuran, vëllezërit e Jozefit, në mënyrë që ta hiqnin qafe, e hodhën Jozefin në një pus. Mirëpo, Jozefi u nxorr nga disa udhëtorë të cilët kalonin atypari. Ata e fshehën Jozefin si një mall tregtie dhe e shitën atë në Egjipt për një çmim të vogël. Kurani e përshkruan këtë shkëmbim si *dar?hima ma'd?datin*. Mirëpo, sipas misionarit të krishterë Joseph Smith, përdorimi i *dirhamit* gjatë kohës së Jozefit, siç rrëfëhet në Kuran, është një anakronizëm.

Në qershor të vitit 2005, si pjesë e serisë së konferencave dhe seminareve të punës dhënë para Forumit të Lidërshipt Evropian Evangjelist në Sopron të Hungarisë, Smith krahas misionarëve Keith Small dhe Andy Bannister si edhe të tjerëve, ishin përgjegjës për krijimin e metodave, taktikave dhe strategjive aktuale për evangjelizimin e muslimanëve në nivel ndërkombëtar. Në një leksion të tillë dhënë për misionarë të tjerë nga vende të ndryshme evropiane, Smith diskutoi disa gabime “emocionuese” të pretenduara në Kuran. Smith tha para audiencës së tij se përmendja e *dirhamit* në historinë e Jozefit në Kuran tregon se Kurani ka qenë redaktuar shumë kohë pasi përfundimisht është shpallur (sipas muslimanëve). Ai thotë [deklarata e tij është në harkun kohor 30:48–32:58]:

... disa prej tyre janë mjaft emocionante të përdoren dhe ju vërtet mund të luani me muslimanët tuaj të cilët sjellin këto histori, ose ju thjesht mund t'ju nxirrni para tyre dhe vetëm t'ju pyesni ata e më pas u thoni të vijnë javën e ardhshme me përgjigjet. Ata janë të zotë në këtë, pasi shumë muslimanë, nuk kanë asnjë ide që këto probleme ekzistojnë në Kuran, dhe tezën që do t'ju japim juve do të jetë në internet. Unë kam rreth 30 ose 40 gabime të tilla që ju mund t'ju paraqisni. Këto janë të paktën 10 që unë kam këtu dhe të cilat janë në të lehtë për t'u përdorur. Lermëni t'ju jap një shembull të dirhamit. Dirhami, dhe kjo do të zhvendoset drejt e në atë çfarë Keith do të thotë më vonë dhe kjo është sërish historia Jozefit... pra është ajo historia e plotë të cilën ne do ta hulumtojmë. Kur Jozefi iu shit egjiptianëve, ai u shit për disa dirhamë të numëruar. Dhe kur ju pyesni për dirhamë të numëruar, ju hamendësoni pra se po përdoren monedha. Monedhat numërohen. Ju pyesni, vallë a kanë pasur monedha në kohën e Jozefit? Nuk ka patur monedha. Nëse shkon në muzeun britanik, dhe ne bëme një tur atje për të parë të gjitha provat biblike, dy orë duke vështruar provat biblike, provat arkeologjike, Dhjetën e Vjetër, nga periudha asiriane, babilonase dhe perse, dhe ne mund t'ju tregojmë se në seksionin e monedhave, numizmatikës, ku ka dirhemë, por gjëja joshëse është se nuk ka monedha para shekullit të shtatë para shekullit të shtatë p.e.s.. Monedhat nuk kanë ekzistuar, kanë qenë shufra, ka qenë masë e peshuar. Pra, Bibla gjithashtu bën këtë pretendim tek Zanafilla, ku është, Zabafilla 37:28 që Jozefi ka qenë shitur për 20 shekelë. Shekeli nuk është një monedhë, është shufër. Në fakt, ne tani e dimë nga tabelat mneuzike (?) se ky është pothuajse çmimi i një skllavi rreth asaj periudhe kohore. Pra Bibla jo vetëm jep denominimin e saktë, por jep gjithashtu edhe monedhën e saktë.

Le t'i kthehemi dirhemit. Shikoni, mbase Zoti po i jepte një shpallje Muhamedit në atë kohë dhe po përdorte një monedhë që ata do ta kishin njohur në atë kohë, kështu mbase njerëzit që jetonin atje në shekullin e shtatë përdornin dirhemët. A e përdornin ata? Jo, nuk e përdornin. Dirhemi u krijua vetëm në vitin 642. Umar(?) ishte ai që futi drahmën. Por muhamedi vdiq në vitin 632. pra si mund të ketë marrë Muhamedi një shpallje që përdor një monedhë e cila ende nuk ka ekzistuar për dhjetë vjet të tjerë? Kemi një problem këtu, apo jo? Është sikur unë t'ju pyesja nëse do ta bleja këtë orë në vitin 1960 për 20 euro. Në vitin 1960 ju nuk do ta dinit për çfarë po flisja. Sot do tad init, por jo në 1960. dhe këtu kemi një vështirësi. Dhe menjëherë ju mund ta kuptoni se çfarë po ndodh. Kjo duket si diçka që është vendosur shumë më vonë në Kuran.

Argumenti i Smithit mund të përmbledhet kështu. Së pari, Jozefi iu shit egjiptianëve për pak dirhemë të numëruar. Sipas Smith, vetëm monedhat numërohen, dhe, nuk ka patur monedha në kohën e Jozefit, kanë qenë shufra. Së dyti, dirhemi u krijua vetëm pas shfaqjes së Islamit dhe ishte Umri (vdekur në vitin 644) i cili prezantoi dirhemin për të zëvendësuar drahmën. Rrjedhimisht, profeti Muhamed (vdekur në vitin 632) përdori emrin e monedhës e cila nuk ekzistoi edhe për dhjetë vjetë të tjerë. Me fjalë të tjera, përdorimi i dirhemit në historinë kuranore të Jozefit është një anakronizëm.

A janë analizat e Smithit, hamendësime dhe përfundime të bazuara në një kuptim të fortë të historisë numizmatike të lindjes së afërme të lashtë? Në këtë tezë, ne do të dëshironim të shqyrtonim pretendimet e Smithit sa i takon dirhemit nga këndvështrimi i historisë dhe i filologjisë. Ne do të diskutojmë gjithashtu shitjen e Jozefit në Egjipt nga këndvështrimi i egjiptologjisë për të parë nëse egjiptianët e lashtë vërtet kanë përdorur forma të ndryshme të argjendit për transaksionet e tyre.

2. Dirhemi: Një Hetim Historik & Filologjik

Diskutimi për monedhat e lashta përfshin disa terma teknikë. Rrjedhimisht, le të identifikojmë disa përcaktime kyçe. Së pari, monedha. Në lidhje me “monedhën” Key Definitions In Numismatics, Përcaktimet Kyçe në Numizmatikë, thotë:

Monedhë: Copë metali, e shënuar me një pajisje, e lëshuar nga autoriteti qeveritar me qëllim që të përdoret si para.^[1]

The Seaby Coin Encyclopaedia e përcakton “shufrën” as:

Shufra: Metal jomonedhë, zakonisht prej ari ose argjendi, në formën e shufrave, pjatave apo formave të rregullta.^[2]

Të armatosur me këto informacione, le të diskutojmë çështjet e ndërlidhura me *dirhamin*, *shekelin* dhe “monedhat” në Egjiptin e lashtë.

HETIMI HISTORIK

Smith ka pretenduar se *dirhami* është future pas shfaqjes së Muhamedit dhe se nuk është krijuar deri në kohën e Umrut. Kjo me fakte është thjesht e pasaktë. Poezia romantike paraislamike e Antara përmend fjalën *dirham*.

[dirham1](#)

Image not found or type unknown

19. Ose goja e saj është si një livadh I pakullotur, barërat e së cilës shiu I ka garantuar, ku s'ka veç pak p
dhe e cila nuk ka gjurmë kafshësh.
20. Ose si të jetë një çalik i vjetër vere, nga Azri'at, e ruajtur gjatë, ashtu si ruajnë mbretërit e Romës;
21. Grimcat e para të çdo reje shiu të rëna mbi të, dhe kanë lënë çdo pellg në të si një dirhem;
22. Sëprkatje dhe zbrazje; kështu që uji rrjedh mbi të çdo natë, dhe nuk është e e ndalur nga ajo.^[3]

Duke komentuar mbi praninë e fjalës Dirhem në poezinë e Antaras, Arthur Jeffery thotë:

Ka qenë pa dyshim një huazim I hershëm nga zona mesopotamase...^[4]

Është e qartë se arabët para islamike kanë pasur dijeni për dirhemin. Historia e dirhemit mund të gjurmohet pas në kohën e monedhës së athinasve (apo grekëve) *drahm*. Monedhat athinase qarkullonin gjerësisht në Mesdheun Lindor në shekullin e 5 dhe 4 p.e.s. Këto monedha athinase, dikur monedha e n johur dhe universale, u bë shpejt një objekt imitimi nga popujt të cilin ishin familjarizuar me to. Imitimi i llojeve të monedhave athinase në Arabinë Jugore, daton në vitin e hershëm 400 p.e.s..^[5] Monedhat e imituara athinase janë gjetur gjithashtu në Arabia Feliks veriore.^[6] Monedhat athinase I dhanë gjithashtu jetë një numri të serive imituese edhe në Arabinë Lindore. Gërmimet në Thaj, Dhahran, al-Khobar, al-Hofuf, al-Qatif, Ayn Javan, al-Sha'ba, Jabal Kenzan, ed-Dur dhe Mleiha kanë nxjerrë një mori monedhash me shumë prej tyre duke qenë imitime të drahmeve dhe tetradrahemeve.^[7] Pa kurrëfarë çudie, të gjitha monedhat të gjetura në kto gërmime tregon ndikimin e monedhave të nxjerrave nga Aleksandri i Madh.^[8] Drahmia në Persi iu kalua Perandorisë Parthian (150 pes- 226 es) nga Perandoria Seleucide greke (330 pes- 150 pes) dhe kur mbretëria sasanide (226 es – 650 es) mori pushtetin në Persi, *drahmia* ka qenë e njohur *drahm* në Persinë e Mesme.

Arabët para islamikë kanë qenë ose nënshtetas persë (në Mesopotami) ose aleatë (në Arabi). Ata gjithashtu kanë mbajtur monedhën perse dhe kanë pasur një fjalë për të– *dirham*. *Drahmia* ka qenë quajtur *dirham* në arabisht;^[9] dhe në atë të parën gjithashtu ka patur kuptimin e monedhës së argjendtë ose parasë.^[10] *Drahmia* e argjendtë ka qenë monedha kryesore e Persisë sasanide. Encyclopædia Iranica në lidhje *dirhamin* thotë.

DIRHAM (< Greqisht. *drakhmé* “drachma”; Persisht e Mesme *drahm*, Persisht *derham*), njësi e monedhës së argjendtë dhe me peshë...

1. Në Persinë Para Islamike

Dirhami mbante një vlerë të qëndrueshme prej 4 g përgjatë të gjithë periudhës para Islamike...

1. Në Periudhën Islamike

Për muslimanët çdo monedhë e argjendtë ka qenë dirhem, dhe një dirhem ka qenë gjithashtu njësi monetare që mund ose nuk mund të përfaqësohet nga një monedhë qarkulluese. Një dirhem ka qenë gjithashtu një njësi e vogël peshe, zakonisht jo e njëjta me peshën e një dirhemi monetar...^[11]

Ngjashmërisht Encyclopaedia Of Islam thotë për dirhemin:

DIRHEM. I. Emri i një peshe të rrjedhur nga greqishtja *dracme*... II. Njësia e argjendtë sistemit monetar arab nga shfaqja e Islamit dero në periudhën mongole.^[12]

Nuk është befasuese që dirhemi islamik ka qenë një rezultat logjik i *drahmes* sasanide. Vetë emri i denominimit ka qenë një përshtatje e *drahmes*, emri për copën e argjendtë sasanide. Pa kurrëfarë habie, monedhat sasanide dhe monedhat arabo-sasanide gjatë shfaqjes së Islamit kanë qenë të lidhura ngushtë.^[13] Monedhat më të hershme arabo-sasanide kanë qenë bërë në vitin 651 es, vitin e mundjes përfundimtare të Jezdegird III. Dirhemët arabo-sasanidë kanë qenë imitime të atyre të nxjerra nga Jezdegird dhe kanë qenë saktësisht të datuara në vitin e 20 të sundimit të tij, vetëm duke shtuar se ata kanë shtypur “në emër të Allahut”.^[14] Si *drahmia*, *dirhami* ka qenë I sheshtë dhe mjaft I hollë, rreth 29 mm në diametër dhe me peshë 2.9 – 3.0 gramë.^[15] Peshë e tij sygjeronte një ulje të standarteve nga *drahmia* sasanide e cila peshonte rreth 4 gramë. Si krahasohet *dirhami* me *shekelin* e shpallur me të madhe të Smithit? Sa I takon *shekelit*, The Universal Jewish Encyclopedia (Enciklopedia Universale Judaikë) thotë:

Shekeli, një peshë dhe më pas një monedhë, e cila ka shërbyer si një vlerë standarte në mesin e izraelitëve dhe çifutëve të lashtë. Me sa duket ka qenë bazuar në një standart të ngjashëm me atë të babilonasve, të cilët si populli kryesor tregtar i Orientit të lashtë, ngulitën tek kombet fqinjë standartet e tyre të monedhës.^[16]

Qartazi, edhe *dirhami* edhe *shekeli* kanë qenë pëdorur si pesha dhe monedha. Mirëpo, ngjashmëritë ndërmjet tyre përfundojnë me kaq. *Dirham* përfaqësonte çdo monedhë të argjendtë. Gjithashtu mund të jetë një njësi monetare që mund ose nuk mund të përfaqësohet nga një monedhë. Për rrjedhojë, duhet patur kujdes kur diskutohet dirhemi, duke qenë se është një fjalë me një shumësi kuptimesh.

HETIMI FILOLOGJIK

Është njohur nga filologët, si muslimanë ashtu edhe ata jo muslimanë, se fjala *dirham* ka origjinë joarabe. Për shembull, al-Jav?l?q? (*vdekur në 1145 es / 539 AH*) deklaron në të tijin Al-Mu'arrab:

Dhe *dirhemi* është një formë e arabizuar. Në të kaluarën, e kanë përdorur atë në ligjërimin e tyre. Ata nuk kanë njohur ndonjë tjetër (monedhë); ata ia kanë atribuar atë *Hijras*. Poeti thotë:

Në të gjitha tregjet e Irakut (ai merr) një haraç, dhe në çdo gjë të shitur nga një individ (ai ngarkon) një *dirhem*.^[17]

Në mënyrë të ngjashme, al-Khaf?j? thotë në lidhje me *dirhem*:

(Dirhem) Forma e arabizuar e *daramit*.^[18]

Jeffery thotë se origjina përfundimtare e *dirhemit* vjen nga fjala greke *drakhmé*.^[19] Mirëpo, nuk është e qartë se si kjo fjalë kaloi në persisht para se të hynte në fjalorin arabisht në kohërat para islamike. Është interesante të vihet në dukje se *drakhmé* e greqishtes fillimisht ka patur kuptimin “një grusht”,^[20] më pas u bë një peshë e pastaj monedhë.^[21]

PËRMBLEDHJE

Nga diskutimi ynë, ka tre përfundime që mund të nxirren në lidhje me *dirhem*.

1. Ka qenë i njohur ne mesin e arabëve para islamikë dhe fjala arabe *dirhem* erdhi nga *drahm* në perisist.
2. Gjatë shfaqjes së Islamit, çdo monedhë e argjendte ka qenë *dirhem* dhe ka qenë gjithashtu njësi monetare që mund ose nuk mund të përfaqësohej nga një monedhë qarkulluese.
3. Ka qenë një njësi peshe dhe monedhe.

Marrë parasysh këto fakte, është e qartë se argumentat e Smith në lidhje me shfaqjen e parë të *dirhemit* gjatë kohës së Umrit dhe se *dirhemi* ka qenë thjesht një “monedhë” janë përfundimisht të hedhura poshtë. Le të kthejmë tashmë vëmendjen tonë te fraza *dar?hima ma'd?datin*, pra pak copa argjenti, të numëruara. Hans-Wehr Dictionary Of Modern Written Arabic e përcakton *ma'd?d* si

ma'd?d: i numëruar, i numërueshëm, i përlogaritur; i kufizuar në numër, i vogël, pak, paksa, disa.^[22]

Pohimi i këtushëm i Smith është se vetëm monedhat numërohen dhe se nuk ka patur monedha në kohën e Jozefit – ka qenë shufra që ka qenë përdorur për shkëmbime. Ai më pas citon nga libri i Zanafillës se Jozefi ka qenë shitur për 20 *shekelë*.

Nëse vërtet monedhat kanë qenë numëruar dhe jo shufrat, është befasuese të shikohet se Smith kundërshton veten duke thënë se shitja e Jozefit u bë me vlerën e 20 *shekelëve*, qartazi një shumë e cila ka qenë numëruar. Gabime kaq skandaloze nuk janë të pazakonta për Smith. Mbase ai nuk është në dijeni të faktit se shufrat kanë patur peshë të standartizuar gjë e cila bënte të mundur që ato të numëroheshin. Përndryshe, paraja nuk do të ekzistonte.

Dikush do të duhet të bëj shkëmbim (madje dhe kjo do të përmbante një lloj numërimi!). Çdo përmendje e një monedhe që nuk është e numërueshme është një oksimaron ose një kundërshti. Është si të thuash, ne po flasim një gjuhë që nuk mund të komunikohet. Me përcaktim, një gjuhë është

e komunikueshme, dhe me të njëjtën gjëndje shpirtërore, me përcaktim, çdo system monetar që bazohet mbi peshën ose letrën është i numërueshëm.

Fjala *ma'd?d* sygjeron një sasi të vogël metali të shkëmbyer në dorë, të cilat kanë qenë të shkëmbyeshme. Sa i vërtetë është ky deklaram nga pikëpamja e Egjiptit të Lashtë? Në mënyrë që të kuptohet se si është zhvilluar tregtia në Egjiptin e lashtë, le të kthejmë tani vëmëndjen se mënyra se si ka qenë përdorur metali në transaksionet e Egjiptit të lashtë.

3. Metalet e Çmuara si Mjet Tregtie në Egjiptin e Lashtë

Në këtë seksion ne do të dëshironim të tregonim disa fakte siç janë përdorimi i meteleve në Egjiptin e lashtë, peshat dhe masat e përdorura për të përcaktuar sasinë e sistemit monetyar egjiptian, si dhe faktet për një sistem të hershëm “të monedhave” në Egjiptin e Lashtë.

Kjo qartazi do të përcaktojë rolin e metaleve të çmuara, dhe të argjendit në veçanti, si një pjesë e rëndësishme e shkëmbimeve të biznesit në Egjiptin e lashtë. Do të diskutohet mënyra në të cilën janë përdorur metalet e çmuara dhe më pas do ta shohim të krahasuar me frazën kuranore *dar?hima ma'd?datin* (pak copa argjendi, të numëruara) të përdorur në shitjen e Jozefit në Egjipt. Në fund, do të krahasohet dhe vihet përballë shitja e Jozefit siç përmendet në Bibël dhe në Kuran, duke nxjerrë në dritë problemet me polemikat e misionarëve.

METALET E ÇMUARA SI MJETE SHKËMBIMI

Ndonëse ka prova të mjaftueshme për një lloj të hershëm “të monedhave”, studiuesit thonë përgjithësisht se monedhat kanë të panjohura në Egjiptin e lashtë para dinastisë së 26 (685 – 525 p.e.s.).^[23] Për pasojë, çmimet e mallrave duhet të shpreheshin në një formë tjetër. Të gjitha format e tregtisë në Egjiptin e lashtë ndodhnin në formën e trambës apo shkëmbimit, ndërsa vlera e mallrave të shkëmbyer shprehej ndonjëherë gjithashtu në sasi bakri, argjendi apo ari. Ndërsa një sistem i tillë shkëmbimesh me siguri ka ekzistuar në nivel lokal, ajo duhet të konsiderohet si pjesë e një sistemi më të gjerë në të cilin metalet e çmuara kishin funksionin e një forme monedhe. Mbishkrimi i famshëm Abydos u referohet tregtarëve që i përkisnin tempullit dhe tregtia e tyre përmbante metalet e çmuar. Mbishkrimi thotë:

Ju kam dhënë një anije që bart ngarkesa mbi Të Gjelbërtin (Det) të Madh, që të sjellë për ju të mëdhatë (mrekulli) të Tokës së Zotit; tregtarët ushtrojnë tregtinë e tyre, zbatojnë urdhrat e tyre, të ardhurat e tyre, të ardhurat e tyre prej kësaj janë në ar, argjend dhe bakër.^[24]

Në mënyrë të ngjashme, *Papyrus Lansing* nga Periudha e Mbretërisë së Re, duke lavdëruar jetën e shkruarit e krahason profesionin shkrimor me të tjerët. Aty thuhet:

Tregtarët çalltisin rrjedhave tëposhtë dhe tatëpjetë dhe janë të zënë me punë si një vegël, duke bartur mallra njërit vend në tjetrin dhe duke furnizuar atë që nuk ka, ndonëse njerëzit e taksave bartin ar, më të çmuarin nga të gjithë mineralet.^[25]

Shkruesi këtu është përpjekur të tregojë rraskapitjen e tregtarëve duke vënë përballë vlerat relative të metaleve në të cilat ata thuhën se bëjnë marrëveshjet. Meqë kompozimi i kushtohet avantazheve të profesionit të shkrimësisë, kjo thjesht drejton kah kontrasti ndërmjet tregtarëve dhe tagrambledhësve, duke sygjëruar se njerëzit e taksave e përfitonin arin nga tregtratë punëshumë.

Një tjetër provë që tregon se metalet e çmuara si argjendi kanë qenë përdorur në transaksione vjen nga *Papyrus BM 10052*, sërisht nga Periudha e Mbretërisë së Re. Këtu një mbrojtje ligjore jepet nga një grua e cila ka qenë marrë në pyetje në lidhje me argjendin e vjedhur nga varret. Kur pyetet për të shpjeguar burimin e argjendit që ajo zotëron, ajo sqaron:

... e kam marrë [pra, argjendin] në shkëmbim të elbit në vitin e hienave kur ka patur zi buke.^[26]

PESHAT DHE MASAT E PËRDORURA NË SHKËMBIMET E METALEVE TË ÇMUAR

Në lidhje me shkëmbimet me metale të çmuara në Egjiptin e Lashtë, ka patur të gjindshme sisteme të ndryshme, më shpesh I përdoruri I të cilëve ka qenë krahasimi I vlerës së një malli me një peshë të caktuar bakri ose argjendi, dhe shumë rrallë të ari. Kjo peshë ka qenë quajtur *deben* (*dbn*) [Figura 1] dhe një e dhjeta e saj ka qenë njohur si *kite* (*kdt*) [Figura 2];^[27] kjo e fundit me sa duket nuk ka qenë përdorur me bakrin.^[28] *Deben* ka qenë 13 gramë gjatë Mbretërisë së Vjetër, pasha e tij u rrit në 91 gramë gjatë Mbretërisë së Mesme. Në Periudhën e Mbretërisë së Re, *debeni* ka qenë ndarë në 10 *kite* prej 9.1 gramë secili, me peshë më të vogël të shprehur si fraksion të një *kite*.^[29] Për rrjedhojë ai përbënte një sistem të “çmimeve” për përdorim në trambë dhe tregti. VVeigall ka treguar prova nga një shkrim I Mbretërisë së Vjetër të fjalës *deben* në kontekstin e peshave ku ajo shkruhej me një përcaktor rrethor. ^[30] Në të paktën një shembull kjo përskruhet në mënyrë më specifike si një unazë e hapur.

Dirhem 2

Image not found or type unknown

Figura 1: Hieroglif që shkruan “deben” (dbn).^[31]

Dirhem 3

Image not found or type unknown

Figura 2: Hieroglif që shkruan “kite” (kdt).^[32]

Dirhem 4

Image not found or type unknown

Figura 3: Hieroglif që shkruan “shaty” (sh’ty).^[33]

Mënyra e dytë e të shprehurit të çmimeve është me krahasimin e vlerës së një malli me një object argjendi I cili në Egjiptin e lashtë ka qenë quajtur në mënyrë të ndryshueshme *shat* (*sh’t*) / *shenat* (*shn’t*) / *shaty* (*sh’ty*) / *seniu* (*sniv*) ^[34] [shiko Figurën 3 për *shaty* (*sh’ty*)]. Kjo njësi vlere ka qenë subject I diskutimeve të gjera ndërmjet egjiptologëve. Pikëpamja më e pranuar në mesin e egjiptologëve është ajo e Peet i cili ka përkthyer këtë fjalë si “copë”, ndonëse ai mendonte se kuptimi zanafillor ka qenë

“unazë”. [35] T. G. H. James preferuan përkthimin edhe më neutral “njësi”. [36] ?erný I cili ka studiuar vlerën e “copës” (pra, *sh'ty*) ka qenë në gjendje të vërtetonte [37] një pikëpamje të mëparshme të Gardiner [38] se *sh'ty* peshonte sa 1/12 e një *debeni*.

Vlera relative e metaleve ka qenë gjithashtu e gjindshme në Egjiptin e lashtë me termat *deben* dhe *sh'ty*. *Rhind Mathematical Papyrus, Papirusi Matematikor Rhind*, nga koha e Hyksos e Periudhës së Dytë të Ndërmjetme (1674 – 1553 p.e.s.) përbën një shembull të tillë. [39] Papirusi ka 84 probleme me shembuj të punuar dhe një shembull i veçantë merret me çështjen e vlerave relative të arit, argjendit dhe plumbit në terma të *debenit* dhe *sh'ty*.

Shembull i llogaritjes së një çante që përmban metale të çmuara. Nëse të thuhet ty, një çantë ku ka ar, argjent dhe plumb. Kjo çantë blihet për 84 *sh'ty*, çfarë është e caktuar për çdonjërin metal të çmuar?

Ajo që jepet për një *deben* ari është 12 *sh'ty*, për atë argjendi 6 *sh'ty* dhe për një *deben* plumbi 3 *sh'ty*. Duhet të mbledhësh bashkë atë që është dhënë për një *deben* të çdo metali të çmuar: rezulton 21. Duhet të llogarisësh këtë 21 për të gjetur 84 *sh'ty*, pasi kjo është ajo që është blerë në këtë çantë. Vjen te 4, të cilat ti ia cakton çdo metali. [40]

Tani shtrohet pyetja: a janë *debeni* dhe *sh'ty* shembuj të “monedhave” në Egjiptin e Lashtë? Këtë ne do ta diskutojmë në skesionin tjetër.

DEBEN DHE SH'TY (OSE SH'T): PROVA TË “MONEDHAVE” NË EGJIPTIN E LASHTË?

Më pas u tha se monedhat kanë qenë të panjohura në Egjiptin e lashtë para Dinastisë së 26. Mirëpo, ka prova të mjaftueshme për të sygjerruar se Egjipti ka patur një lloj sistemi monedhash deri në Periudhën e Mbretërisë së Vjetër (2700 – 2200 p.e.s.). Le të shqyrtojmë tani faktin në mënyrë kronologjike.

Dirhem 5

Image not found or type unknown

Figura 4: Skenë tregu në varrin e Niankhkhnun dhe Khnumhotep në Saqqara (Dinastia e 5, Periudha e Mbretërisë së Vjetër).^[41]

Mbase skena më informuese që ka të bëjë më *sh't* shfaqet në një varr që i përket Niankhkhnun dhe Khnumhotep në Saqqara (Figura 4). Niankhkhnun dhe Khnumhotep kanë qenë dy zyrtarë të lartë të cilët kanë jetuar në Dinastinë e Pestë të ndërmjetme të Periudhës së Mbretërisë së Vjetër. Skena në varrin e tyre tregon një treg të hapur dhe gëlues me tregtarë që ofrojnë një sërë varieteti mallrash. Ka të paktën katër stenda të ndryshme perimesh dhe frutash, dy ekspozime peshqish, një tregtare grua që shet mjete lundrimi dhe shitësa që qëndrojnë pranë një shkalle që shfaq veshje. Me interes për ne skena e fundit. Këtu dy shitësit mbajnë veshjet në duar, mbase prej liri, bëjnë një trambë (rreshti 4, në anën e djathtë):

... kube pëlhere në shkëmbim për 6 *sh't*.^[42]

Shkëmbimi vlerëson një gjatësi të caktuar të veshjes me 6 6 *sh't* ndërsa të gjitha shkëmbimet e tjera në varrin e Niankhkhnun dhe Khnumhotep janë tramba të drejtpërdrejta. Është me interes të vihet në dukje se blerësi nuk tregohet me object reciprok të cilin ai mund ta këmbëjë me pëlhurën; por atij i jepet çmimi i pëlhurës kundrejt *sh't*. I njëjti standart vlere shfaqet gjithashtu edhe në tekstet e Mbretërisë së Vjetër. “Dokumenti i Blerjes së Shtëpisë ” nga Xhiza përdor *sh't* për të përcaktuar vlerën e veshjeve dhe të mobiljeve. Këtu shtëpia kushton 10; në këmbim një pëlhurë me katër shtresa jepet për 3 *sh't*, një pëlhurë me dy shtresa për 3 *sh't* dhe një krevat për 4 *sh't*.^[43]

Ka gjithashtu disa prova të një sistemi monedhash të bakrit. Papirusi Hekanakhte nga Dinastia e 11 ^[44] nga Periudha e Mbretërisë së Mesme (2040 – 1991 p.e.s.) jepë provë për *deben* bakri të përdorur për monedha. Hekanakhte, fermer, i ka dërguar letrën agjentit të tij ku thotë:

Tani shiko! Të kam dërguar përmes Sihathor 24 *debenë* bakri për marrjen me qera të tokës.^[45]

Çuditërisht, Baer e ka përkthyer këtë si “24 *deben* prej bakri”.^[46] James thotë se “letra thotë mjaft qartë ‘24 *debenë* bakri’, jo ‘24 *debenë* prej bakri’, e cila duhet të nënkuptonte 24 copa prej bakri secila me peshë një *deben*.”^[47] Mund të theksohet se referenca bëhet vetëm për numrin e *debenëve*, duke sugjeruar qartazi se ato ishin të një cilësie standarte metali si edhe të një peshe standarte.

Papirusi Boulaq 11, i botuar fillimisht nga A. Mariette,^[48] i ribotuar nga VVeill^[49] dhe më pas nga Peet,^[50] që datonte në Dinastinë e 18 të Periudhës së Mbretërisë së Re (1570 – 1293 p.e.s.), është madje edhe më interesant. Shumica e shkëmbimeve në këtë papirus shfaqen të jenë debite të hyra përkundër emrave të tregtarëve të ndryshëm, por ka një transaksion që tregon qartazi një tregtar që paguan për blerjen e tij me *sh't* ari.

Muaji i dytë i Përmbytjes, dita e 25, marrë nga tregtari Baki

6. 2½ *sh't* ari në pagesë për mish.^[51]

Për habi, ky është i vemti shembull i njohur ku një *sh't* ari ka qenë përdorur në vend të të zakonshmit argjend. Duke pranuar se ky shkëmbim përfshin pagesë në 25, James ka argumentuar nga harresa e hyrjeve ku mallrat vlerësohen në terma të të barazvlefshmit të tyre në metal, se “ne nuk duhet të dalim në përfundimin se pagesat bëheshin në fakt në metal siç specifikohet. Nëse bëheshin kështu, nga kjo do të rrjedhonte se metalet, në veçanti arid he argjendi, kanë qenë përdorur zakonisht si para në kuptimin më të vërtetë; gjë nga e cila duhet të vijojë se sasi të konsiderueshme të këtyre metaleve

ishin në qarkullim, të gatshme për tregti, dhe kalonin rregullisht nga dora në dorë. “[52] Në dritën e *Papirus Boulaq 11*, ku një tregtar paguan shprehimisht në ăar dhe ku mallrat vlerësohen në terma *sh’t* prej ari, nuk ka asnjë arsye të përjashtohet përdorimi i arit në shkëmbimet tregtare. Ka gjasa që kjo tregti ka ndodhur në nivelet e larta të shoqërisë së Egjiptit të lashtë. Ne kemi parë tashmë se mbishkrimi i famshëm Abydos I referohet tregtarëve që shkëmbejnë në ăar, argjend dhe bakër.

Pllakati me mbishkrim I dinastisë së hershme të 18 të Ahmose-Nefertari nga Karnak përmend transferimin e 1010 *sh’t* në formë ari, argjendi, bakri, gruri dhe toke.

Lista pra

Ar: 160, argjend: 250, bakër:

Totali: 1010 *sh’t*

I kam dhënë asaj një shërbëtor mashkull dhe një femër, x sasi gruri, 5 aroura tokë në Egjiptin e Poshtëm në vlerë 1010 *sh’t* ndonëse puna e saj ishte (vetëm) 600 *sh’t*.^[53]

Mbishkrimi Rekhmire nga dinastia e 18 e Periudhës së Mbretërisë së Re gjithashtu ia vlen të përmendet. Një shqyrtim I të dhënave të taksave në këtë mbishkrim tregon se ndërsa sasia e arit të paguar si taksë mbi punën varion nga rreth 5 në 6 *deben*, komandanti I fortesës së Elephantinës paguan jo më pak se 40 *debenë* dhe komandanti I fortesës së Bigeh paguanste 20 *debenë*. Në anën tjetër, kreu i Edfu paguante 8 *deben* ari si taksë.^[54] Duket se zyrtarët nga kufiri jugor ishin në pozitë të mirë për të marrë ar.

Papirusi Turin 1881 nga Periudha e Mbretërisë së Re është një rast interesant. Ai ka të bëjë me ar, argjend dhe bakër I dhënë nga një tempull për racionet e Necropolis. Në Egjiptin e lashtë ka qenë e zakonshme që mallrat të vlerësoheshin në terma të metalit për shkëmbim. Në këtë papirus, gjithësesi metalet vlerësohen në ekuivalentë të *khar* gruri.

Dëftesë e *?d* nga përfaqësuesi Minkhau I tempullit të Isis për racionet e Necropolis: ar I mirë 1 *kite*, I barazvlefshëm me 5 *khars* (drithi); argjent 4 *kite*, I barazvlefshëm me 6 *khar*, një shami koke, e barazvlefshme me 2 *khar*, dhe 20 *deben* bakri, të barazvlefshëm me 5 *khar*.^[55]

Metalet ashtu si veshjet kalsifikohen si *?d* e cila përveç kuptimit parësor të “argjendit”, kishte përfituar edhe kuptimin e përgjithshëm të “pagesës” për të gjitha llojet e mallrave.^[56] duke komentuar mbi këto shkëmbime, Castle thotë:

Duke marrë parasysh faktin se të barazvlefshmit e grurit jepen për sasi të metalit, mund të jetë e tillë që metali sigurohej për qëllimin e blerjes së racioneve të zakonshme të grurit nga një palë e tretë, me më shumë gjasa një individ ose tregtar privat sesa një tempull tjetër. Në anën tjetër, të barazvlefshmit e grurit mund të tregojnë sasinë e zakonshme të pagesave të grurit, të cilat zëvendësohen nga pagesat në metal për disa arsye, mbase në shfaqjen e mungesë të përkohshme gruri. Sidoqoftë, metali duhet të konsiderohet si një formë paraje.

Vetë fakti se *?d* mori kuptimin e gjerë të “pagesës”, sugjeron se shkëmbimi I argjendit në shkëmbimet tregtare ishte ose ka qenë një praktikë e përgjithshme.^[57]

Përfundime të qarta që kanë të bëjnë me qarkullimin e metaleve të çmuara janë arritur nga Kemp. Ai thotë se:

... në duhet të pranojmë se sasi të konsiderueshme ari dhe argjendi kanë qenë gjithnjë në qarkullim. Kjo do të shpjegonte për shembull, arin e gjetur në varret e Periudhës së Parë të Ndërmjetme në zonën Qau... Kjo do të shpjegonte gjithashtu se si arid he argjendi u paraqit së tepërmi në mesin e mallrave të përdorur nga qytetet dhe qarqet provinciale për pagesën e taksave lokale që l vësheshin zyrës së vezirit, siç përshkruhet në varrin e Rekhmira...^[58]

Nëse metalet e çmuara si ari, argjendi dhe bakri qarkullonin në Egjiptin e lashtë, cila ishte forma e tyre? Me se ngjasonin ato?

MË TREGO PARATË!

Më sipër është përmendur se VVeigall ka treguar prova të Mbretërisë së Vjetër të shkrimit të fjalës *deben* në kontekstin e peshave ku ajo është shkruar me një përcaktor qarkor dhe të paktën në një shembull kjo përshkruhet më specifikisht si një unazë e hapur. ^[59] Vlera kryesore leksikore e *deben* duket të përfshijë një formë rrethore, duke sygjyer se fillimisht në kontekstin e metaleve *deben* dëshmonte për një unazë,^[60] mbase të një peshe të përcaktuar e cila më pas u bë standart. Përfundimet e VVeigall u kundërshtuan nga Peet porva nuk mund të shitet me aq lehtësi.^[61]

Në kontekstin e Papirusit Hekanakhte, është parë se fermeri ka propozuar pagesën e tokës duke përdorur "24 *debenë* bakri". Në këtë rast është e qartë se debeni duhet të konsiderohet si një objekt konkret, jo thjesht një njësi peshe. Nënkuptimet e kësaj janë të mëdha. Ka një mundësi që kjo do të thotë unaza bakri që peshojnë një *deben* secila. Kjo është pikërisht ajo çfarë ka thënë James.

Siç shkruhet kjo duhet të përkthehet '24 *debenë* bakri', pra, 24 copa bakri, çdonjëra prej së cilës peshon një *deben*... Për pasojë, mund të dilet në përfundimin se bakri ka qenë përgatitur në shufra dhe unaza të vogla me peshë standarte për komoditet tregtie dhe shkëmbimi madje që në kohën e Dinastisë së XI. ^[62]

Është me interes të vihet në dukje se tekstet që janë diskutuar nuk thonë as që *debeni* apo *sh't* kanë qenë peshuar as testuar për cilësi. Kjo sygjeron se të dy, si blerësi ashtu edhe shitësi kanë qenë të ndërgjegjshëm për kuptimin e *deben* apo *sh't* dhe çfarë përfaqësonin ato.

Peet ka sygjyer gjithashtu që *sh't* fillimisht l referohej një objekti metali dhe jo një mase abstrakte të vlerës.^[63] siç është përmendur më parë *sh't* duket se ka ekzistuar krahas *shn' / t*, shot këtu edhe një shkrim tjetër *seniu* (*sniv*). *shn'* shfaqet me *sh't* si sinonim në dy versione të Gërmëzimi 129 i Librit të të Vdekurve.^[64] Në Papirusin Hekanakhte l cili është diskutuar më parë, të shkruarit e *sh't* duket se është korrigjuar në *shn't* me shtimin e *n*. kjo shfaqet tri herë në dokument. Në një rast *n* shkruhet brenda *sh* të *sh't*.^[65]

Vente beson se *shn'* e Gërmëzimit 129 të Librit të të Vdekurve do të thotë “unazë” ose “vulë”.^[66] Në mënyrë të ngjashme ?erný ka vënë në dukje se *sh't* “shfaqet disa herë në një tekst magjik të Dinastisë së 18, ku ai duket se emërton “plumbin” e sheshtë të një unaze të vulës personale.”^[67] Pra edhe *deben* edhe *sh't* duket se kanë formën e një “unaze”. Për më tepër, Castle ka nxjerrë në pah se *sh't* me shumë gjasa ka rrjedhur nga *sh'*, “me prerë”,^[68] dhe kjo pra do t'i referohej të pririt të saj nga një spirale mëmë të një trangu shufër. ^[69]

Prova nga Egjipti i lashtë rrëfen për faktin se metalet e çmuara kanë qenë sjellë në formën e volitshme të unazave. Përfaqësimet e arit dhe argjendit në këtë formë shfaqen në varret e Rekhmire^[70] dhe Sobekhotep.^[71] Unazat shpesh duken të jenë të hapura dhe të lidhura në formën e zinxhirëve [Figura 5(a)]. Gjetjet në terren të thesarëve nga Tell el-Amarna tregojnë se argjendi gjithashtu ka qenë sjellë në këtë formë [Figura 5(b)].^[72]

Dirhem 6

Image not found or type unknown

(a)

Dirhem 7

Image not found or type unknown

(b)

Figura 5: (a) Një skenë nga varri i Sobekhotep, një zyrtar i lartë thesari i sundimit të Thutmose IV. Africanët sjellin unaza të arta dhe grimca të çmuara të papërpunuara nga Nubia.^[73] (b) Unaza të argjendta, copa të argjendta dhe një shufër e papërpunuar, një pjesë e një reserve të gjetur në një kavanoz në Tell el-Amarna. Unaza e tretë nga e majta fill nën shufër tregon një skicim të skalitur, mbase një mnyër për t'u siguruar për pacënueshmërinë e unazës. ^[74]

Gjatë zhvillimit të monedhave, ka qenë e nevojshme të garantohej dhe sigurohej pacënueshmëria e monedhave nga krruajtja e metalit. Për këtë arsye monedhat e metaleve të çmuara erdhën duke u dhëmbëzuar përgjatë buzëve. Zbatimi i një procedure të tillë mund të mos ketë qenë e mundur në

rastin e unazave të metalit dhe nëse nuk ndodhur, do të kishte qenë e pasuksesshme. Kjo do të kishte rezultuar patjetër në peshimin e metalit gjatë shkëmbimeve tregtare. Duket se ka përpjekje për të mbrojtur pacënueshmërinë e unazave në Egjiptin e lashtë. Tre unaza metali në rezervat e Tell el-Amarna janë raportuar të kënë patur të gdhendura skicime në skajet e tyre [Figura 5(b)].^[75]

Pacënueshmëria e unazave të arit, argjendit dhe bakrit (prej *debeni* ose *sh't*) duhet të ketë qenë e vështirë të ruhej përkundër pandershmërisë dhe nevoja për vlera të ndara (pra, *kite*) duhet të ketë rezultuar në më tepër peshë. Me fjalë të tjera, nuk duhet të kish qenë më e mundur apo e nevojshme të mbahej pasha e saktë e unazave. Standarti është ruajtur në sajë të peshimit. Weigall ka treguar disa shembuj të mbishkruar të peshave nga Egjipti i lashtë për këtë standart.^[76]

Duket se përdorimi i unazave të metalit për tregti ka qenë mjaft i përhapur. Rezervat e metalit që mbanin unaza të hapura dhe skrap të ngjashëm me atë nga Tell el-Amarna janë gjetur në Ugarit,^[77] dhe në një rast ka të qenë unaza dhe skrap elektrumi.^[78] Sollberger ka ënë gjithashtu në dukje përdorimin e unazave të argjendit në tekstet Ur III dhe sugjeronte se “unazat në fjalë do të ishin të ngjashme me ato unaza të mirënjohura helikoidale nga varret evropiano veriore të fillimit të mesjetës. Pagesat e dhuratave mund të bëheshin nga prerja e copave të barazvlefshme me sasinë e dëshiruar.”^[79]

Mirëpo, prova më dramatike e përdorimit të unazave për tregti vjen nga Mesopotamia. Povvell ka tërhur vëmëndjen në faktin se metalet janë tregtuar në Mesopotami në një formë të paraqitur në tekstet *har* sumerian, që i korrespondon *ševirum* (ose *šemerum*, *semerum*) akadian.^[80] Ai propozon se këto fjalë për një object rrethor. Ato nuk do të thonë thjesht “unazë” në kuptimin e zakonshëm, por mund t'i referohen një spirale metali, një formë e volitshme në të cilën metalet trajtoheshin dhe përdreshin për qëllime moneatare [Figura 6]. Castle vë në dukje se kjo korrespondon ngushtë me atë që është përmendur për *debenin* egjiptian, si etimologjikisht ashtu edhe në përdorim.^[81]

Dirhem 8

Image not found or type unknown

Figura 6: Spirale të argjendta nga Mesopotamia të përdorura “para” për tregti.^[82]

Sugjerimi i Povvell është mbështetur gjithashtu nga teksti i akadianes së vjetër i cituar nga The Assyrian Dictionary Of The Oriental Institute Of The University Of Chicago, Fjalori Asirian i Institutit Oriental të Universitetit të Çikagos.

semeru: ... pagoi katër shura (të argjendta), çmimi i njëzet deleve...^[83]

Ashtu si në rastin e *deben* dhe *sh't* egjiptian, vlera nominale e këtyre unazave mund të mos korrespondojë saktësisht me peshën e tyre të vërtetë siç jepet në tekste. Kjo nuk është shkak vështirësie meqënëse ato do të ishin peshuar në dorëzimin gjatë shkëmbimeve tregtare.^[84] Për të

përmbyllur diskutimin me studimin e Castle mbi tregtinë në kohën e Ramesside:

... e qartë se metalet e çmuara kanë qenë dhënë edhe si skrap ashtu edhe në formën e unazave helikoidale gjatë gjithë hënës pjellore, dhe ato kanë qenë përdorur si një formë monedhe mjaft herët në Mesopotami, dhe në Egjipt pa dyshim nga Periudha e Mbretërisë së Re, dhe mbase edhe më herët.^[85]

ÇFARË KA NË ATO ÇANTA TË LIDHURA PAS SHPATULLAVE?

Një tjetër provë për sistemin e hershëm të monedhave në Egjiptin e Lashtë, ndonëse e tërthortë, shpesh e papërmendur, janë skenat e tregut.^[86] Tipari mbase më i spikatur në skenat e tregut është pa dyshim prania e njerëzve që mbajnë trasta të vogla liri të hedhura pas shpatullave, diçka e ngjashme me një kuletë [Figurat 4 dhe 7]. Ky tipar vërtetohet në shumë prej skenave të tregut nga Periudha e Mbretërisë së Vjetër e këtej. Ngjyra e trastës pas shpatulla është zakonisht e bardhë. Çështja tani është se çfarë mund të kenë mbajtur këto trasta ose kuleta? Ka një debat në mesin e egiptologëve se për çfarë qëllimi kanë shërbyer këto trasta.

Dirhem 9

Image not found or type unknown

Figura 7: Përshkrimet Mastaba të skenave të tregut nga Dinastia e 4 e Periudhës së Mbretërisë së Vjetër që tregon tregtarët me trasta të vogla liri të lidhura pas shpatullave.^[87]

Është e qartë se këto trasta nuk mund të kenë qenë përdorur për të sjellur mallrat në treg. Burrat që kanë trastat të hedhura pas shpatullave përfaqësohen si nga blerësit ashtu edhe nga shitësit. Hodjash dhe Berlev dalluan dy lloje skenash: në skenat e tregut ku shiten rezerva ushqimore, vetëm blerësit kanë trasta dhe në skenat ku mallrat e prodhuar shiten, shitësit janë ata me trasta.^[88] Kjo gjithashtu mundëson pikasjen e një dallimi ndërmjet atyre që blejnë dhe atyre që shesin. Hodjash dhe Berlev janë të opinionit se trasta pas shpatullave kanë shërbyer si një vend për të mbajtur paratë dhe sendet me vlerë, diçka e ngjashme me një kuletë, ndonëse ata kanë dyshuar në ekzistencën e parasë metalike në Egjiptin e lashtë.^[89] Meqënëse *deben* dhe *sh'ty* të bërë nga metalet e çmuar u përdorën në shkëmbimet tregtare në Egjiptin e lashtë, nuk do të ishte e habitshme të shikoheshin të mbaheshin në kuleta të vogla.

SHITJA E JOZEFIT NË KURAN, TEFSIR DHE BIBËL

Është përmendur sa më sipër se Kurani përshkruan shitjen e Jozefit si *dar?hima ma'd?datin* . Al-Zamakhshar? në të tijin al-Kashsh?f në lidhje me frazën *dar?hima ma'd?datin*, thotë:

“{*sharauhu*} Ata e shitën atë {*bithamanin bakhsin*} për më pak se çmimi i duhur kaq qartë [...] {*dar?him*} saqë është, jo *din?rë* {*ma'd?datin*}, kaq të pakta sa mund të numëroheshin dhe të mos peshoheshin. Vërtet, ata nuk do të peshonin masa më të vogla se një *uqiyyah* e cila është e barabartë me 40 *dirhamë* dhe do të numëronin çdo sasi poshtë këtij(kufiri). Për më tepër, sasi të vogla kualifikohen si *ma'd?dah*, meqënëse sasi të mëdha nuk mund të numërohen (lehtësisht). Është rrëfyer me autoritetin

e Ibn ‘Abb?s se: (çmimi) ka qenë 20 *dirhemë*. Sipas al-Sudd?: ka qenë 22 *dirhemë*. [...]”

Në mënyrë të ngjashme, al-Tabari në Tefsirin e tij thotë:

